



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:280127  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05625292

Ac.nr.2657/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. H. nga fshati Zh., Komuna e Vitisë, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, rr. “L. H.” p.n. Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson, D. B., jurist, për kompensimin e pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.385/2017, të datës 18.02.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit Xh. H. nga fshati Zh., Komuna e Vitisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.385/2017, të datës 18.02.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.385/2017, të datës 18.02.2020, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Xh. H. nga fshati Zh., Komuna e Vitisë, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensojë tri paga bazë në shumë prej 3,402.90 euro, dhe në emër të kompensimit me rastin e pensionimit, t’ia kompensojë tri paga përcjellëse në shumë prej 3, 402.90 euro, gjithsej në total shumë prej 6, 805.90 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit apo ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet që e paditura të ketë paraqitur përgjigje në ankesë. Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e paditësit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 31.10.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit për shpërblim jubilar dhe paga përcjellëse me rastin e pensionimit. Në padi ka pretenduar se e paditura detyrohet në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës që paditësit ti kompensojë shumën prej 3.090,00 € në emër të shpërblimit jubilar dhe shumën prej 3.090,00 € në emër të pagave përcjellëse për pensionim, me kamatë prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 08.02.2021, administrimit dhe shqyrtimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.385/2017, të datës 18.02.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se “ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte kontestues vetëm fakti nëse e paditura duhet t’ia kompensojë paditësit shumat e kërkuara e që bazën e kanë në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e lidhur me datë 18.03.2014. Fakti se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura u vërtetua me Vërtetimin e lëshuar nga KGJK, mbi përvojën e punës të datës 09.07.2015, ndërsa, me vendimin e lëshuar nga KGJK të datës 12.05.2017 me numër 03/243 u vërtetua fakti se paditësi me datë 13.06.2017 i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me kërkesën e datës 17.03.2017 u vërtetua se paditësi i është drejtuar tani të paditurës KGJK, që kjo e fundit t’ia paguaj shpërblimin jubilar, ndërsa me regjistrin e pagave të datës 31.05.2017, është vërtetuar se paga bazë e paditësit ka qenë 1,134.30 euro.”

Për mënyrën e vendosjes i është referuar nenit 7, paragrafi 1 të LPK-së derisa për shpenzimet e procedurës ka zbatuar nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në Viti dhe kjo dëshmohet përmes Vendimit mbi përvojën e punës 01-478, të datës 09.07.2015 nga e cila është vërtetuar se i njëjti ka pasur gjithsej 35 vite dhe 1 (një) muaj, lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, fakt ky që nuk ka qenë kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, kjo për faktin se paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë mbi të cilat do ti vërtetonte pretendimet e tij kundrejt detyrimit të të paditurës për ti kompensuar në emër të shpërblimit për paga jubilarë dhe paga përcjellëse shumë e kërkuar në vlerë të përgjithshme prej 6.180,00 € dhe me të drejtë kërkesa e tij nuk gjen mbështetje në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas të cilës paditësi i ka kërkuar këto kompensime. Kjo pasi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është nënshkruar i kësaj kontrate dhe se pagat përcjellëse dhe shpërblimi jubilar për gjyqtarët e Republikës së Kosovës nuk janë të përcaktuara as me Ligjin për Gjykatat në Republikën e Kosovës e as me ndonjë ligj tjetër në fuqi andaj pretendimi ankimor se e paditura përfaqësohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshjeje dhe nga kjo rrjedh detyrimi për kompensim, vlerësohet si pretendim i paqëndrueshëm dhe i pabazuar pasi që nënshkrimi nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Organizatat e punëdhënësve dhe të punësuarve për lidhjen e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës nuk paraqet detyrim për të paditurën Këshillin Gjyqësor të Kosovës duke pas parasysh pushtetet e ndara nga e cila pushteti ekzekutiv nuk mund të marr të drejta dhe detyrime për pushtetin gjyqësor.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse për pension si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2657/2021, më datë 23.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj